



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KËSHILLI KOMUNAL PËR SIGURI NË BASHKËSI

EKSTRAKT

nga procesverbali i mbajtur më 27 korrik 2018, në mbledhjen e tretë(3) të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi

Mbledhja u mbajt në sallën nr. 31 dhe filloi në orën 10.05

Në mungesë të Kryetarit të Komunës z. Agim Veliu, mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Nënkryetari i Komunës z. Nexhmi Rudari.

Fillimisht u vërtetua se në mbledhje ishin të pranishëm: z. Bekim Bislimi, Komandant i Stacionit të Policisë; z. Radisav Perović, përfaqësues i Komunitetit serb; z. Enver Rama, përfaqësues i komunitetit rom; z. Shaban Ahmeti, kryesues i Komitetit për Komunitete; znj. Naime Podvorica, zyrtare për Barazi Gjinore; z. Agim Blakçori, U.D. drejtor i Drejtorisë së Arsimit; z. Naim Bajraktari, kapiten, përfaqësues i FSK-së; z. Qefser Behrami, përfaqësues i Këshillit Lokal për Siguri Publike-Kërpimëh; z. Nuhi Selimi, përfaqësues i Këshillit Lokal për Siguri Publike-Orllan; z. Rizah Muçolli, kryesues i Ekipit Veprues për Siguri në Bashkësi, z. Faik Muçiqi, përfaqësues i emergjencave civile; z. Liman Zeqiri, përfaqësues i Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim dhe znj. Donjetë Sheqiri, përfaqësuese e OJQ-ve, mediave lokale, komunitetit të biznesit dhe komunitetit të personave me nevoja të veçanta.

Ndërsa mungoi: z. Osman Kurtolli, përfaqësues i Këshillit të Bashkësisë Islame.

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi.

Në mbledhje ishin të pranishëm edhe: Përfaqësuesi i KFOR-it dhe z. Skender Shatri, Bekim Karaxhia- OSBE.

z.Nexhmi Rudari, Nënkryetar i Komunës, theksoi, pasi që Kryetari i Komunës do të vonohet ca, do të fillojmë me mbledhjen e KKS-së, andaj mirë se keni ardhur dgu falënderoj për pjesëmarrje më lejoni të hapi mbledhjen e KKS-së. A ka ndonjë vërejtje apo plotësim lidhur me rendin e ditës.

Rend i ditës

U miratua njëzëri

1.Raporte të Policisë së Kosovës dhe KFOR-it për gjendjen e sigurisë në Komunë

z.Nexhmi Rudari, Nënkryetar i Komunës, theksoi, fillimisht fjalën e ka Komandanti i Policisë z. Bekim Bislimi.

z.Bekim Bislimi, gjendja e sigurisë në Komunë vlerësohet e qetë dhe stabile dhe nuk pritet në të ardhmen që të ketë eskalim në raport me sigurinë e përgjithshme. Gjatë kësaj periudhe në disa fusha, në disa forma, kemi ngritje të numrit të veprave penale, ku veçohen rastet e vjedhjeve të rënda, është një fenomen në rritje edhe dhuna në familje, megjithatë krahasuar në total të veprave penale kemi rënie të tyre. Sa i përket gjendjes në komunikacion, krahasuar me priudhën e vitit të kaluar kemi rënie të aksidenteve. Në Nivel qenror të Policisë së Kosovës për shkak të gjendjes në komunikacion është krijuar një taskforcë e cila fushëveprimin e ka në parandalimin e aksidenteve, në këtë drejtim edhe Stacioni jonë policor është i kyqur. Sa për krahasim këtë vit kemi numër shumë më të madh të veturave sesa në vitin e kaluar. Si çështje të cilën e kemi diskutuar shumë herë dhe gjendje e cila afekton në punën dhe aktitetet policore është mungesa e

personelit policor. Një numër i tyre është në moshë të konsideruar por edhe me probleme shëndetësore, gjë që po reflekton në kryerjen e detyrave primare të tyre, e që kjo vështirësohet edhe më nga numri i kërkesave për asistencë policore nga mekanizmat e ndryshëm institucional. Kërkoj që të na mbështesni në këtë drejtim sepse sigurisht që ndikon në përmirësimin e gjendjes në terren.

Përfaqësuesi i KFOR-it, theksoi, nga këndvështrimi ynë gjendja e sigurisë në Komunë vlerësohet e qetë, nuk ka pas ndonjë sfidë që dëmton sigurinë dhe kjo është arritur në bashkëpunim me institucionet komunale FSK-në dhe Policinë, bashkëpunim të cilin jemi të interesuar ta vazhdojmë. Pra sipas nesh gjendja e sigurisë është stabile.

z.Nexhmi Rudari, Nënkretar i Komunës, para se të hapim debatin për këtë pikë isha ndërlidhë me dy çështje që përmendi Komandanti i Stacionit të Policisë, që janë në interes për të gjithë ne, përmendi takimin që ka pas Kryetari i Komunës me U.D të Drejtorit të Policisë dhe çështja tjetër që është me rëndësi e që po shkakton probleme të shumta jo vetëm të qytetarëve të Komunës së podujevës janë ngecjet në punimet në magjistratlen Podujevë- Prishtinë, në veçanti në udhëkryqin te hotel Besiana dhe në fshatin Gllamnik, duke pasë parasysh edhe numrin e madh të automjeteve që po hyjnë në pikën kufitare në Merdar, po krijohen kolona të gjata të automjeteve, është një pjesë të rrugës me potencial të madh për shkaktim të aksidenteve në komunikacion. I bëj thirrje Komandantit që për periudhën deri në muajin shtator, për shkak të ngarkesave në këtë rrugë të ket sa më shumë raporte të policisë, jo për ti dënuar qytetarët por për ti siguruar që jeta e tyre të jetë e sigurt në trafik. Siç e përmendi Komandanti është shqetësuese për të gjithë ne është mungesa e parkingjeve, por nuk mund të thuhet se është mungesa e parkingjeve sepse ka parkingje private të mjaftueshme por që nuk shfrytëzohen, por që vozitësit e pandërgjeshëm i ndalin dhe parkojnë automjetete e tyre në hapësira publike, me që rast pengojnë qarkullimin e lirë në përgjithësi qoftë të qytetarëve ashtu edhe të automjeteve. Nuk jam në dijeni me numrin e tiketave të shqiptuara, por pjesa e dërmuese e trotuareve të qytetit janë të bllokuara nga makinat e parkuara. Kjo mbetet si shqetësim sa i përket trafikut. E theksoj se nuk është përgjegjësi e Komunës por as e Stacionit të Policisë së Podujevës tollovitë që shkaktohen në pikën kufitare në Merdar, ajo është një çështje që i takon Nivelit Qendror, por për ne shqetësuese mbetet niveli i pastërtisë ku udhëtarët presin me orë të tëra dhe hudhin mbeturinat jashtë dhe kjo i jep një pamjet të shëmtuar asaj pjese. Ne shpesh herë e dërgojmë kompaninë pastrimi, por është e pamundur që këtë ta bëjmë çdo ditë.

z.Liman Zeqiri, theksoi, edhe vitin e kaluar ka qenë e ngritur çështja e personelit policor, por nuk e di se sa ne jemi në gjendje të ndikojmë si Këshill në këtë drejtim për shtimin e numrit të zyrtarëve policor, pasi që vendimmarrjen e bëjnë organet nga Niveli Qendror. Duke marrë për bazë faktin se Komuna jonë është në mesin e komunave më të mëdha me si për nga territori ashtu edhe në kuptimin demografik, ne si Këshill a do të mund të bënim kërkesë institucioneve relevante, që të ndihmohet në shtimin e numrit të personelit në funksion të punës më efikase.

z.Nuhi Selimi, theksoi, e përgëzoj Komandantin e Policisë për punën dhe angazhimin e tij, megjithatë sikurse theksoi para folësi numri i zyrtarëve policor është shumë i vogël, fjala vjen në pjesën e liqenit të Batllavës gjatë kësaj periudhe si rajon turistik është e nevojshme për prezencën e një numri më të madhe të zyrtarëve policor.

Shqetësim është edhe për shkak të vozitjes së shpejtë të automjeteve në atë pjesë. Këtu duhet të veprohet, por gjithashtu duhet angazhuar edhe në funksion të vetëdijesimit të tyre.

z.Bekim Bislimi, është evidente se në takimin e përbashkët të Kryetarit me Ministrin e MPB-së dhe me U.D të Drejtorit të Policisë kërkesë kryesore ka qenë rritja e kapaciteteve, rritja e numrit të zyrtarëve policor. Angazhimi ynë është maksimal por me këto kapacitete nuk kemi mundësi të bëjmë më shumë.

z.Naim Bajraktari, theksoi, në FSK, ka arritur një informatë për formimin e një njësie të re, Njësinë e Intelejencës. Në këtë njësi do të transformohet Njësia në kuadër të së cilës jam i sistemuar dhe transformimi do të bëhet përmes Ambasadës Amerikane. Kjo tash ka filluar dhe do të përfundoj vitin e ardhshëm. Nuk jam në dijeni për rrjedhën e proceseve dhe nuk jam i sigurt se a do të jem unë në kuadër të Këshillit edhe pse i kemi pasur disa plane, përderisa jam këtu do të mundohem në implementimin e tyre. Kjo do të jetë një Njësi e mirë për të ardhmen, në interes të sigurisë së përgjithshme dhe besoj se unë do të jem ai i cili do tua paraqes informatën e sakt se si

do të jetë koordinimi mes autoriteteve civile dhe atyre ushtarake. Kjo do të jetë përmes Abasadës Amerikane. Njësia do të jetë në kuadër të strukturave më të larta shtetërore.

z.Nexhmi Rudari,Nënkryetar i Komunës, meqë nuk të tjerë të interesuar rreth raporteve, kalojmë në pikën e radhës.

2.Shqyrtimi dhe miratimi i ekstrakteve të procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura më 06 qershor 2018 dhe 14 qershor 2018

U miratuan njëzëri

3.Implementimi i projektit të vendosjes se kamerave të sigurisë në qytet

z. Nexhmi Rudari,Nënkryetar i Komunës, theksoi, është një temë me interes të cilën e kemi trajtuar para dy vitesh e cila është paraqitur edhe përmes projektorit. Besojmë se vendosja e kamerave në pikat kyqe ndihmon në preventivën e veprave penale, krijon një ndjenjë të sigurisë te qytetarët jo vetëm për çështjet në trafik por për të gjitha çështjet nga fusha e sigurisë, pa cenuar privatësinë e qytetarëve. Për këtë temë ftoj Komandantin të na informojë më gjerësisht, sa jemi afër të implementimit të këtij projekti të rëndësishëm.

z. Bekim Bislimi, sikurse e theksoi Nënkryetari ky projekt është shqyrtuar më parë. Projekti është shumë i nevojshëm në aspektin e ngritjes së sigurisë së përgjithshme. Ne kemi formuar një ekip the kemi identifikuar të gjitha ato pikat për të cilat kemi menduar si të rëndësishme në funksion të parandalimit të veprave. Projekti përfshinë qytetin dhe pjesët periferike të Komunës së Podujevës. Kur është prezantuar projekti ka qenë prezent edhe ICITAP-i dhe janë deklaruar se janë pro këtij projekti dhe do të shiqojnë mundësitë të na ndihmojnë, mirëpo deri më tani nuk ka pas lëvizje konkrete. Për projektin është një mbështetje e drejtëpërdrejtë e Kryetarit. Është e nevojshëm që të paktën të fillohet me implemenrimin e projektit, me planifikim që ky të përfundohet gjatë viteve në vijim. Projekti është shumë i rëndësishëm, i nevojshëm dhe i domosdoshëm, ka treguar rezultate në komunat tjera, konkretisht në komunën e Ferizajit. Projekti ka një kosto jo të vogël, varësisht edhe prej kualitetit të pajisjeve. Efektet në parandalimin e veprave të ndryshme të inkriminuara do të dukeshin padyshim.

z. Nexhmi Rudari,Nënkryetar i Komunës, theksoi, besoj që çmimi i këtyre pajisjeve s’do duhej të ishte problem, sepse teknologjia është duke u zhvilluar shumë shpejtë, kështu që kur të përgatitet paramasa dhe paralogaria specifikat e kësaj teknologjie duhet të jenë ato të fundit, më cilësoret. E hap debatin për këtë temë.

z. Faik Muçiqi, për vendosjen e kamerave ka një vit që kemi vendosur që të fillohet me implementimi e projektit. Tani jemi në këtë fazë por që nuk ka diçka konkrete, ndoshta sigurisht duke pritur donatorë jashtë këtyre dy institucioneve. Duke parë që vonesat e tilla mund të vazhdojnë atëherë Komuna dhe Stacioni Policor duhet të ndërmarrin hapa konkret, bazuar në mundësitë e tyre financiare. Tani më projekti duhet të jetë i gatshëm me paramasa dhe paralogari dhe mendoj se Kryetari i Komunës dhe Komandanti i Policisë duhet të lidhin një marrëveshje bashkëfinancimi për fillimin e realizimit të projektit. Së paku këtë vit të fillohet me 50% të projektit, sepse i njëjti duhet të jetë disa vjeçar.

Pas arritjes së Kryetarit të Komunës në takim, Nënkryetari e informoi për rrjedhën e takimit, në veçanti për temën rreth implementimit të projektit për vendosjen e kamerave.

Me kryesimin e mbledhjes vazhdoi z. Agim Veliu, Kryetar i Komunës.

Theksoi, nëse nuk ka dikush diçka tjetër kalojmë në pikën e radhës.

4.Diskutim për projektet që ndikojne në sigurinë e qytetareve (të infrastrukturës dhe të shërbimeve) që mund t’i propozohen drejtorive, për miratim në Kuvendin Komunal

z.Nexhmi Rudari, Nënkryetar i Komunës, në këtë pikë është menduar të diskutojmë për projektet e ndryshme që lidhen me sigurinë qytetarëve të Komunës së Podujevës , projekte të infrastrukturës së ndryshme, të cilat Komuna dhe institucionet tjera do të mund t’i realizonin, në mënyrë që të krijohet më shumë siguri për qytetarët.

z.Faik Muçiqi, theksoi, meqenëse çdo vit raportojmë, jemi në dijeni për projektet e infrastrukturës dhe të shërbimeve që ndikojnë në sigurinë publike. Sipas Udhëzimit Administrativ përkatës Këshilli ka të drejtë të propozojë projekte Kuvendit komunal përmes Drejtorive përkatëse. Meqenëse jemi në fazën e hartimit të projektbuxhetit për vitin 2019, Këshilli ka mundësi që ato projekte të cilat Drejtoritë nuk i kanë paraparë t'i propozojë dhe ti shqyrtojmë pasi në shtator miratohet buxheti i Komunës. Pasi që ju vini nga rrethe të ndryshme, sigurisht që jeni në dijeni edhe për nevojën e realizimit të ndonjë projekti, fjala vjen mungon ndonjë ndriqim, shenjzim i rrugëve, trotuar etj, projekte që ndikojnë në ngritje të sigurisë, andaj nëse keni diçka konkrete t'i paraqitet Drejtorive. Ne kemi paraqitur draftin e buxhetit të Komunës dhe një numër i konsiderueshëm i këtyre projekteve janë paraparë, por është e mundshme që kemi harrur ndonjë që është me rëndësi kështu që është e drejtë e juaja të propozoni.

z. Bekim Bislimi, në takimet që kemi pas janë diskutuar çështjet kryesisht për projektet në infrastrukturë dhe në raport me ngritjen e nivelit të sigurisë, ne i kemi adresue në Drejtori. Ku kemi vërejtur se ka mundësi të bëhet diçka me interes në këtë fushë i kemi adresuar. Për këtë gjashtë mujor prapë do të rishikojmë dhe kur të vlerësojmë fjala vjen te shenja afër rruge kemi probleme ose duhet të ngrisim nivelin e sigurisë së qytetarëve ne do të adresojmë me shkrim, është rasti pikërisht ura në fshatin orllan që lidhet me fshatin Bërvenik, e kemi adresuar, ka qenë kërkesë e anëtarëve të KLSB-së.

z. Nuhi Selimi, theksoi, kam disa propozime të projekteve që ndërlidhen me çështjen e sigurisë dhe atë; vendosjen e barrierave ku ka nevojë në aksin e rrugës magjistrale për në fshatin Orllan, për shkak se ka ndodhë që disa herë kanë pësuar me automjete; Rregullimin e trotuarit sidomos kah ura, kjo është kërkesë që e kemi ushtruar edhe më parë si dhe vendosjen e pengesave në rrugë pran shkollës së fshatit, për shkak të vozitjes së shpejtë.

z.Liman Zeqiri, theksoi është një shqetësim të cilin e kemi diskutuar edhe vitet e kaluara, e që qëndron edhe sot. Fjala është për rrugën Podujevë–Shajkoc, kyçja në fshatin Sfeçël, konkretisht për objektin që mbulon pamjen në rrugë dhe që ende qëndron , ku si pasojë ka pas ndeshje me fatalitet, nuk e di se a mund të bëhet diçka aty.

z.Agim Blakçori, theksoi, kam një kërkesë për Drejtorinë e Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit që t'i jep prioritet projekteve për rregullimin e trotuareve në rrugët në drejtim të shkollave, sepse kjo ndikon drejtpërsëdrejti në sigurinë e nxënësve.

z. Qefser Behrami, kur jemi te projektet për çështje të sigurisë kam një shqetësim, pran shkollës në fshatin Kërpimëh bëhet vozitje e shpejtë e automjeteve, e pakontrolluar dhe nëse nuk vendosen pengesa në rrugë është shumë rrezik të ndodh ndonjë fatkeqësi te nxënësit. Po ashtu si nevojë tjetër kemi ndërtimin e trotuarit te shkolla në fshatin Metehi.

z.Naim Bajraktari, theksoi, te shkolla në fshatin Batllavë, mendoj se është me prioritet ngritja e një muri mbrojtës rreth 200 m, për të penguar depërtimin e ujit në oborr të shkollës. Konsideroj se me këtë bëhet zgjidhja e problemit.

z. Agim Veliu, Kryetar i Komunës, theksoi, këto propozime rreth projekteve i kemi parasyshtë, e shoh se shumica janë të parapara si projekte në draftin e parë të projektbuxhetit të Komunës. Disa prej projekteve ne si Këshill duhet adresuar në Ministri sepse ka rrugë që sipas kategorive janë në kompetencë të Ministrisë, jo të Komunës dhe për çkado që investohet ose duhet ta kemi pëlqimin e tyre ose të realizohet nga ana e tyre(Niveli Qendror), kështu që ne ato projekte që janë në përgjegjësinë tonë t'i parashohim deri në momentin e aprovimit të buxhetit. Kalojmë në pikën e radhës.

1. Informatë për aktivitetet e KKS-së në vitin 2017

z. Agim Veliu, Kryetar i Komunës, fjalën e ka U.D. Drejtor i Drejtorisë së Arsimit z. Agim Blakçori.

z. Agim Blakçori, lexoi në tërësi informatën duke i informuar anëtarët e Këshillit për gjendjen e sigurisë në shkolla gjatë vitit shkollor 2017-2018, të cilën e vlerësoi të qetë dhe të sigurt. Në këtë aspekt Drejtori foli për bashkëpunimin me institucionet relevante përgjegjëse, në funksion të mbarvajtjes së procesit mësimor dhe për ruajtjen e rendit dhe sigurisë në shkolla.

Drejtori në vazhdim në detaje foli për Kurrikulën e re të arsimit parauniversitar në Komunën e Podujevës, për procesin dhe akterët e zbatimit si dhe për ndryshimet në sistemin arsimor sipas Kurrikulës së re; Sigurimin e transportit të nxënësve me nevoja të veçanta; Organizimin e

ekskursioneve të maturantëve, të cilat siç theksoi janë zhvilluar në pajtim me legjislacionin në fuqi; Shëtitjet njëditore të semimaturantëve gjatë muasjit maj, organizim i cili siç theksoi ka përfunduar pa ndonjë incident; Organizimin e garave shkollore në futboll dhe voleyboll; Testin e arritshmërisë për klasë të nënta(9) dhe testin e maturës për klasë të dymbëdhjeta(12); Organizimin e mbrëmjes së maturës dhe ceremonive të diplomimit të nxënësve të klasëve të nënta(9); Procesin e rexhistrimit të nxënësve në klasë të dhjetë(10); procesin e realizimit të projekteve infrastrukturore si dhe për sfidat në fushën e arsimit. Drejtori në fund foli për Qarkoren Buxhetore 2019/01 sipas së cilës theksoi shqetësim rezulton të jetë kërkesa për shkurtimin e 60 vendeve të punës në vitin 2019. Nënvizoi këtë shqetësim e kemi ngritur në Ministrinë e Financave.

Konstatim: Kryetari i Komunës për shkak të angazhimeve u detyrua të lë takimin, ndërsa Nënkryetari i Komunës vazhdoi me kryesimin e takimit të Këshillit.

Donjetë Sheqiri, sa i përket çështjes së sigurisë në arsim është shqetësues fakti se pran shkollave theksoi lokalet jo vetëm se u shesin cigare nxënësve sikurse e theksoi Drejtori i DA por edhe pije alkoolike dhe ato përdoren edhe brenda objektit shkollor sidomos cigaret.

z. Nexhmi Rudari, theksoi, kemi informacione se cigaret në afërsi të shkollave të mesme të ulta shiten me copë dhe në këtë situatë ne si Komunë nëpërmjet edhe të Inspeksionit duhet ndërmarrë veprime ligjore, sepse shitja e këtyre produkteve është rreptësisht e ndaluar ndaj fëmijëve dhe nxënësve të shkollave deri në moshën 18 vjeçare.

Falënderojmë Drejtorin për paraqitjen e informatës, kalojmë në pikën e radhës.

Konstatim:

Informata është pjesë përbërëse e procesverbalit.

2. Informatë për aktivitetet e KKSBB-së në vitin 2017

z. Nexhmi Rudari, Nënkryetar i Komunës, fjalën e ka z. Faik Muçiqi

z. Faik Muçiqi, i informoi të pranishmit për përmbajtjen e dokumentit. Theksoi Informata përmban të dhënat më kryesore të punëve dhe aktiviteteve të Këshillit për vitin 2017.

Konstatim:

Informata për punët dhe aktivitetet e KKSBB-së për vitin 2017 u kalua pa vërejtje dhe e njëjta procedohet në Kuvendin e komunës.

3. Të ndryshme

z. Liman Zeqiri, është bërë fenomen kjo që po na përcjell, fjala është për rritjen e numrit të atyre që po kërkojnë lëmshë dhe është shqetësuese se ata po vijnë prej territoreve tjera, veçanërisht nga Shqipëria dhe rritja e numrit të tyre është shqetësuese edhe për qytetarët sepse është bërë e tepërt dhe jemi në dijeni se Policia ka probleme me këtë kategori. Është problem i madh dhe mendoj se edhe Niveli Qendror është dashur të merret me këtë çështje, sepse ky mund të jetë ndonjë rrjet i organizuar. Çështja është që në kuadër të mundësive të angazhohemi në uljen e këtij fenomeni që ka marrë përmasa.

z. Bekim Bislimi, theksoi, pajtoj me diskutimin e parafolësit, ky fenomen vërehet pothuajse çdo kund, megjithatë krahasuar me komunat tjera mendoj se ne qëndrojmë më mirë. Ne kemi parasysh këtë kategori dhe do të veprojmë.

z. Nexhmi Rudari, Nënkryetar i Komunës, theksoi, keni parë edhe përmes mediave ku Policia e Kosovës, kryesisht fëmijë të cilët kërkojnë lëmshë të shtyrë nga rrjete të ndryshme i marrin dhe i përcjellin deri në kufi. Çështja e personave më të moshuar që kërkojnë lëmshë e që mund të jenë nga Komuna jonë këta do të duhej të ishin në fokus edhe të Qendrës për Punë Sociale, sepse ka raste prej tyre që janë në asistencë sociale dhe të jenë po ashtu në mesin e atyre që kërkojnë lëmshë, pra këto raste kërkojnë tretman në aspektin profesional nga QPS. Është bërë

dukuri që numëri i personave që kërkojnë lëmoshë të jetë i rritur deri në shkuarjen e bashkëatdhetarëve.

z. Liman Zeqiri, theksoi, ka raste edhe kur në emër të ndonjë personi të sëmurë, persona të ndryshëm depërtojnë nëpër fshatra dhe shtëpi në mënyrë të organizuar, rrejtshëm në emër të shoqatave të ndryshme për të kërkuar të holla, pa kurrfarë autorizimi, edhe pse kjo çështje i takon autoriteteve publike. Prandaj edhe kjo dukuri është mirë të përcillet.

Donjeta Sheqiri, theksoi, si çështje problematike kemi organizimet ilegale të ekskursioneve me nxënës të shkollave të mesme. Kjo nuk është duke u lejuar nga Drejtoria e Arsimit, por po realizohen duke ndikuar edhe pronarët e autobusëve apo agjencioneve të ndryshme turistike, andaj mendoj që kjo çështje të mirret me prioritet sepse siç jemi në dijeni vetëm vitin e kaluar ka pas tri herë organizime dhe ekskursione të tilla dhe si rezultat mund të përfundojnë me pasoja shumë të rënda.

z. Agim Blakçori, theksoi, Komuna e Podujevës është prej komunave të vetme që ka ndërmarrë aksione në parandalimin e këtyre organizimeve të ekskursioneve me nxënës të shkollave të mesme, sepse në mënyrë zyrtare nuk organizohen ato. Ne jemi në bashkëpunim edhe me Inspeksionin komunal dhe me Policinë e Republikës së Kosovës në funksion të parandalimit të këtyre organizimeve.

Nënkryetari përfundoi mbledhjen, ndërsa të pranishmit i falënderoi për pjesëmarrje dhe kontribut.

Mbledhja përfundoi në orën 11.00

**Procesverbalin e mbajti
Sabedin Namani**

**Nr. 02-060/04-0059663/18
Podujevë,
27 korrik 2018**

**Kryetari i Komunës
Agim Veliu**